



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER STELA R. DEMNERI
ADRESA NR.5, GJIK KUQALI,
PALL"FERAR", NR.1, NR.13
TEL: 692437001



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4758

Nr. koleksioni: 1376

Tirane më 07/12/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022051380146435058

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 4758 Rep

Nr. 1376₂ Kol.



A2022051380146435058

**KONTRATË SHITJE KUOTASH KAPITALI
(TË SHOQËRISË “HE & SK 11” SHPK)**

Sot, më datë 07/12/ 2022, para meje Notere Stela R. Demneri, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Nr.5, Gjik Kuqali, Pallati "Ferar", Nr.1, Nr.13, u paraqit personalisht:

PALA SHITËSE:

Z. Mariglen Shehu, atësia Baço, amësia Myzejen, shtetas Shqiptar, lindur në Salari, Tepelenë dhe banues në Tiranë, me adresë Fabrika E Qelqit; Nd. 88/1; H. 1; Njësia Administrative Nr. 6; Njësia Bashkiake Nr. 6; 1027; Tiranë, lindur më 10/10/1983, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032796073 dhe nr. personal **I31010021Q**, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “**HE & SK 11**” sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB me **NUIS L19008502B**, datë 08/04/2011, me adresë Lagja “Mustafa Matohiti”, Rruga mustafa Matohiti, Banesa Nr.31, Shkalla Nr.1, Kati Përdhe, Tepelenë.

PALA BLERËSE:

Z. Henri Çela, atësia Skënder, amësia Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Visha; Nd. 69; H. 4; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 13/08/1996, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032189453 dhe nr. personal **J60813050B**.

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për shitjen e kuotave të kapitalit. Personat deklaruan se informacionet e dhëna për hartimin e kësaj kontrate janë të vërteta dhe se për to mbajnë përgjegjësi. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Kushte paraprake:

1. **Z. Mariglen Shehu** është ortak i vetëm e shoqësirë me 100 % të kuotës së shoqërisë “**HE & SK 11**” sh.p.k. **NUIS L19008502B**.
2. **Z. Mariglen Shehu** ka vendosur të kryej shitjen e 100 % te kuotës së kapitalit që zotëron duke dale kështu nga ortakëria e shoqërisë “**HE & SK 11**” shpk.
3. **Z. Henri Çela** deklaroun se pranon blerjen e kuotës së shoqërisë “**HE & SK 11**” sh.p.k në masën 100 % duke u shndërruar ortak i vetëm me 100 % të kuotës së shoqërisë “**HE & SK 11**” sh.p.k.



Neni 1- Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma “ç” (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma “ç” (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Neni 62, gërma “ll”, neni 63, pika 1, gërma “ç”, si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Neni 2 - Objekti i kontrates

Objekt i kesaj kontrate është shitblerja prej 100 % e vlerë së kuotës së ortakut të vetëm të shoqërisë “HE & SK 11” sh.p.k nga pala shitëse tek pla blerëse kundrejt çmimit prej ALL 1.000.000 (një milion lekë).

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe pagimin e çmimit sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ortak i shoqërisë “HE & SK 11” sh.p.k me 100 % të kuotës do të rezultojë **Z. Henri Çela**.

Neni 3- Cmimi dhe menyra e pageses

Palet kane dakortësuar ndermjet tyre qe vlera totale e kuotës që tjetërohet nëpërmjet kësaj kontrate është ALL 1.000.000 (një milion lekë). Kjo vlerë parash është likuiduar ndermjet palëve kontraktore dhe për këtë palët nuk kanë ndonjë pretendim.

Neni 4 - Regjistrimi ne QKB

1. Kjo kontratë është e vlefshme për palët që nga momenti i nënshkrimit të saj.
2. Regjistrimi pranë QKB kryhet për efekt publikimi dhe këtë procedurë pala blerëse merr përsipër ta kryej sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
3. Me regjistrimin e kontratës pranë QKB, ortakëria e shoqërisë “HE & SK 11” sh.p.k do te rezultojë:
 - **Z. HENRI ÇELA, NID J60813050B – ortak me 100 % (njëqind përqind) të koutës së shoqërisë “HE & SK 11” sh.p.k, NUIS L19008502B.**

Neni 5- Deklarime te paleve

4. Pala shitëse deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotës që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se kuota është e lirë nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.
5. Pala shitëse deklaron se ligji dhe statuti i shoqërisë ja njohin të drejtën për të nënshkruar këtë kontratë kalimi kuote ortakut të shoqërisë.
6. Pala blerëse merr përsipër dhe të kryej regjistrimin në QKB të kësaj kontrate. Shpenzimet e regjistrimit në QKB dhe të kësaj kontrate merren përsipër të paguhen nga pala blerëse.

Neni 6- Zgjidhja e mosmarreshjeve

Çdo lloj mosmarreshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndermjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Palet bien dakord qe depozitimi i aplikimit përkatës për regjistrimin e kalimit të pronësisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, në të kundërt duhet të paguajne kamatëvonesa përkatëse.



A2022051380146435058

Palët marrin përsipër të regjistrojnë dhe publikojnë këtë kontratë në të gjitha institucionet ku regjistrimi/publikimi si procedurë është i detyrueshem dhe aty ku palët kanë interes të regjistrojnë këtë kontratë.

Kontrata u lexua qartë në prani të palëve, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje noteres.

Kontrata u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje me vlera të njëjta juridike mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese.

Unë noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALA SHITËSE

Z. Mariglen SHEHU

Në cilësinë e ortakut të shoqërisë

"HE & SK 11" sh.p.k



PALA BLERËSE

Z. Henri ÇELA

Henri Çela

**NOTERE
STELA R. DEMNERI**


